



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E PASTRIMIT**

NJOFTIM

**“PER ORGANIZIMIN E DEGJESES PUBLIKE NE LIDHJE ME MIRATIMIN E
RREGULLORES SË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE URBANE,
BASHKIA KAMEZ”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015“ Për vetëqeverisjen vendore”,i ligjit nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit nr .319, datë31.05.2018” Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” , Urdhër nr.137,datë17.02.2026 ‘‘Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane” si dhe në kuadër të hartimit të rregullores për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz, si një detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji nr.57/2025,“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” ku në nenin 15 paragrafi “c” përcaktohet se: *“Bashkitë, të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera, të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, që ndodhen në territorin nën juridiksionin e tyre”*si dhe nenit 24 paragrafi “ç” përcaktohet se *“Ngritjen e sistemit bashkiak të grumbullimit, përcaktimin e pikave të grumbullimit, pikave të magazinimit të përkohshëm dhe të stacioneve të transferimit të mbetjeve dhe në përgjithësi të vendndodhjes së infrastrukturës së nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve brenda territorit të bashkisë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për planifikimin e zhvillimin e territorit”*. Ndërmarrja e Pastrimit ,Bashkia Kamëz në bashkpunim me Shoqatën “Bashki të forta”, ka përgatitur një draft për Rregulloren e Menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.

Rregullorja e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (RRMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal,si një dokument /udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.

Kjo rregullore mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon nje qëndrim të përbashkët midis aktorve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal .RRMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit ,trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve dhe saksioneve.

Në vijim të procesit me konsultimin me publikun ,ju ftojm të merrni pjesë në dëgjesën publike pranë Pallatit të Kulturës “Artan Çuku” më datë 26.03.2026, në orën 14:00.